

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian DVORANI - Kryesues
Arjana FULLANI - Anëtar
Andi ÇELIKU - Anëtar

në dhomën e këshillimit të datës 01.02.2017, mori në shqyrtim çështjen administrative që i përket:

PADITËS: Loreta Bakalli

E PADITUR: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

OBJEKTI: Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ Urdhër nr.7803/1, date 25.11.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve "Per lirimin nga detyra të një punonjësi civil" me objekt lirimin nga shërbimi civil të personit tim znj.Loreta Bakalli si specialiste e Sektorit të Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të me paguajë pagën e plote si specialiste të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve përfshirë të gjitha ndryshimet që do të bëhen me akte nënligjore përkatëse që nga momenti i shkëputjes së marrëdhënies financiare date 01.12.2013 deri në momentin e rikthimit në detyrë. Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të më paguajë dëm moral për cenim të personalitetit personal dhe profesional, humbje të vendit të punës pa asnjë shkak të ligjshëm të provuar. Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të paguajë të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe tarifat e pagesës së avokatit.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.10087, datë 26.02.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" i ndryshuar, Akti normativ nr.5, date 30.09.2013 "Per ndryshime në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", ligji nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative. Ligji nr.8549, date 11.11.1999 "Per statusin e nëpunësit civil. VKM nr.306, date 13.06.2000 "Per disiplinën në shërbimin civil". Ligji nr.8485, date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave administrative" neni 618, dhe 625, i ligjit nr.7850, date 29.07.19994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.222, datë 27.01.2014, ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesës padisë së paditëses Loreta Bakalli. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.7803, datë 18.11.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të rikthejë paditësen Loreta Bakalli në vendin e mëparshëm të punës. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të paguajë paditësit Loreta Bakalli pagën deri në rikthimin në vendin e mëparshëm të punës. Përbushja e detyrimit nga pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në favor të paditësit Loreta Bakalli do të bëhet në këtë mënyrë: Pala e paditur detyrohet të paguajë një page mujore çdo muaj si dëmshpërblim paditëses nga momenti i fillimit të ekzekutimit të këtij vendimi deri në rikthimin e saj në punë.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.1592, datë 08.05.2014, ka vendosur:

- 1.Lënie në fuqi të vendimit nr.222, datë 27.01.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
- 2.Kundër vendimit, lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

VENDOSI

Ndryshimin e vendimit nr.222, datë 27.01.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr.1592, datë 08.05.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit në këtë mënyrë: Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të paguajë paditëses Loreta Bakalli, pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës 01.12.2013, deri në rikthimin në vendin e mëparshëm të punës. Lënie në fuqi për pjesën tjetër.

Tiranë më 01.02.2017

Nr. 31001-04626-00-2014 Regj.Themeltar
Nr. 00-2017-643 i Vendimit (21)